



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË

**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 64, Datë 11.04.2022**

**MBI**

**KUALIFIKIMIN DHE PAJISJEN ME CERTIFIKATË TË GARANCISË SË  
ORIGJINËS PËR IMPIANTIN E PRODHIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE HEC  
“MOGLICË”, TË SHOQËRISË “DEVOLL HYDROPOWER” SH.A. PËR VITIN 2020  
DHE 2021**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 3, gërma “ë” dhe nenit 16, pika 6, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; neneve 4, 6, 7 dhe 8, të Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, miratuar nga bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) me vendimin nr. 229, datë 20.12.2019; dhe nenit 15, të Rregullorës për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.04.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 432/2 prot., datë 04.04.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kualifikimin dhe pajisjen me “Çertifikatë të garancisë së origjinës” (GO) për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike “HEC Moglicë”, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a. për vitin 2020 dhe 2021”,

**Konstatohet se:**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 43, datë 16.03.2022, vendosi të fillojë procedurën për kualifikimin dhe pajisjen me Certifikatë të Garancisë së Origjinës për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike “HEC Moglicë”, të shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a.
- Në vijim të këtij vendimi ERE ka njoftuar shoqërinë me shkresën nr. 262/4 prot., datë 23.03.2022 dhe me shkresën nr. 262/3 prot., datë 23.03.2022, i kërkoi OST sh.a. informacion në lidhje me sasinë e energjisë elektrike të injektuar në rrjet nga impianti prodhues i HEC “Moglicë” për vitin 2020 dhe vitin 2021, si dhe destinacionin e kësaj energjie elektrike brenda apo jashtë vendit.
- Shoqëria OST sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 262/5, datë 30.03.2022, ka përcjellë informacionin e kërkuar dhe ka konfirmuar sasinë e energjisë elektrike të prodhuar nga HEC “Moglicë” për vitet 2020 dhe 2021 dhe në lidhje me destinacionin e kësaj energjie, rezulton se veprimtaria është kryer përmes transaksioneve elektroenergjitike në treg të liberalizuar brenda dhe jashtë vendit..
- HEC “Moglicë” nuk ka qenë më parë i pajisur me GO dhe ky është aplikimi i parë i shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., për kualifikim dhe pajisjen me GO të HEC-it Moglicë, i cili ka filluar operimin në datën 06.04.2020.

- Certifikata e Garancisë së Origjinës do të lëshohet për energjinë e prodhuar gjatë vitit 2020 (159,723 MWh) dhe për atë të prodhuar gjatë vitit 2021 (424,643 MWh), sasi kjo e konfirmuar nga OST sh.a. në zbatim të nenit 16, pika 6 të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.
- Në zbatim të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, dokumentacioni i këtij aplikimi rezulton tërësisht i plotësuar si më poshtë:
  - Aneksi 1. Formati i Aplikimit, gërmat “a”, “b”, “c”. **Plotësuar.**
  - Neni 7, pika 7.4 Kërkesa për lëshimin e GO, gërmat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “e”, “ë”, “f”. **Plotësuar.**
  - 7.5 Dokumentacioni teknik, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”. **Plotësuar.**
  - Neni 8, “Procedura teknike e kualifikimit”, pika 8.1, 8.2 dhe 8.3 gërmat “a”, “b”, “c” (i, ii,iii,iv), “d” (i, ii,iii), 8.4. **Plotësuar.**

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE:

#### **Vendosi:**

1. Të kualifikojë impiantin e prodhimit të energjisë elektrike HEC “Moglicë”, të shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a.
2. Të pajisë me Certifikatën e Garancisë së Origjinës impiantin e prodhimit të energjisë elektrike HEC “Moglicë”, të shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a., për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2020 për sasinë e prodhuar 159,723 MWh dhe për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021 për sasinë e prodhuar të energjisë elektrike 424,643 MWh.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**